



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-060-01-20159-24

Nr. i fq. / Br. str. / No pg. _____

Data / Datum / Date

16.07.2024

~~REPUBLIKA E KOSOVËS~~

REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E OBILIQIT

OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.18.06.2024, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani, Labinot Mirena dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH-së, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun dhe përf, e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Planifikimi i buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027
4. Shqyrtimi i kërkesës së DSHMS-së, për Draft Statutin e QKMF-së, "Forma unike e Statutit të QKMF-së"
5. Shqyrtimi i kërkesës së DPUKP-së, lidhur me kërkesën e njësisë KUR Prishtina në Obiliq
4. Shqyrtimi i kërkesave
5. Të ndryshme

Kryesuesja – Fillimisht i uroi festën e Kurban Bajramit, të gjithëve të besimit mysliman. Pastaj, i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Komitetit ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e DEFZH-së, për planifikimin e buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027.

Enver Gashi – Grupi ynë është për atë që ky planifikim i buxhetit të shkoj për shqyrtim në Kuvend dhe aty do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Edhe unë shfrytëzoj rastin të ju uroj festën e Kurban Bajramit. Ne jemi për atë që kjo pikë të shkoj në seancën e Kuvendit Komunal, ndërsa atje do ti japim komentet tona.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Planifikimit të buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga DSHMS-ja, për Draft Statutin e QKMF-së, “Forma unike e Statutit të QKMF-së”. Ju, keni pranuar edhe shtojcën me rekomandime dhe nuk mund të intervenohet në Statutin e QKMF-së, sepse nuk lejohet, por Komisioni e ka bashkangjitur një shkresë duke u mbështetur në Ligjin për Obilinqin.

Enver Gashi – Kjo, kërkesë e DSHMS-së, ka qenë edhe në debat publik dhe janë kryer anët ligjore, kështu që ne si grup jemi për që të shkoj dhe kaloj në Kuvend

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend, ndërsa atë që thate se nuk mund të ndërhyhet duhet ti shpjegojmë apo ti cekim të gjitha në Kuvend sepse në rast se nuk mund të ndërhyhet atëherë, pse diskutohet në Kuvend. Mirëpo, sido që të jetë deri në seancën e ardhshme ne jemi pro gjithësesi që të shkoj në seancë dhe shpresoj se do ta ndryshoj gjendjen për së miri.

Kryesuesja – Ju sqaroj se nuk mund të ndërhyhet sepse është Statut unik dhe ata kanë mendue që Statutit të ia bashkangjesin shtojcën me qenë si shtojcë e Statutit enkas për Komunën e Obilinqit. Në mbledhjen e Kuvendit do të jenë të pranishëm edhe mjekët si dhe Komisioni që do ta shpjegojnë më mirë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DSHMS-së, për Draft Statutin e QKMF-së, “Forma unike e Statutit të QKMF-së”.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e DPUKP-së, lidhur me kërkesën e njësisë KUR Prishtina në Obilinq. Pra, ju materialin e keni komplet.

Enver Gashi – Ne jemi për që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe atje, do ta japim kontributin tonë, por gjithësesi duhet konsultuar anën ligjore për këtë çështje.

Sami Ajeti – Ju, tash e thate se materiali është komplet ndërsa në shkresën që sapo e lexuat është që Kryetari i Komunës të njoftoj Kuvendin Komunal dhe në këtë rast Kryetari i Komunës nuk ka bashkëngjitur ndonjë njoftim që ka të bëjë lidhur me këtë punë. Sido që të jetë ne për këtë pikë të rendit të ditës do të absenojmë.

Labinot Mirena – Është mirë me ardhë ata të ujësjellësit dhe me na shpjegue pak më gjerësisht punën e kërkesës sepse unë besoj se edhe kur është dhënë ai objekt aty, nuk është dashtë me u dhënë në atë pjesën aty, do të thotë e ka zënë njëfarë hapësire gjelbëruese. Pastaj, nuk ka asnjë vendparking dhe nuk e di ujësjellësi në Obilinq, a ka ndonjë makineri, depo apo diçka që e shfrytëzon në Komunën e Obilinqit dhe me ditë saktësisht sa makineri i kanë sepse telashja më e madhe është që po kanë pajisje, por nuk po kanë askund parking. Ne e kemi problem shumë të madh edhe me KEDS-in, që i ka disa zyre nga 1 metër e 20 cm dhe pickupat e tyre i kanë nëpër prona publike, nëpër parkingje të banorëve, që i parkon mjetet e saj. Nëse, nuk ka ndonjë vendparking tjetër në Komunën e Obilinqit, unë personalisht jam për atë objekt aty mos me iu vazhdue, por me u rrënue krejtë dhe të mbetet hapësirë gjelbëruese për banorët.

Kryesuesja – Edhe një herë cila ishte kërkesa juaj në mënyrë që ne pas mbledhjes së Komitetit me adresue në Drejtorinë e urbanizmit.

Labinot Mirena - Kërkesa ime për ujësjellësin është me pyet sa makineri i posedon në Komunën e Obilinqit, a janë të peshave të rënda, apo janë vetura zyrtare dhe nëse, ka makineri a ka në ndonjë pjesë tjetër të Komunës së Obilinqit, ndonjë truall që e shfrytëzom, ose ku i len ato mjete.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DPUKP-së, lidhur me kërkesën e njësisë KUR Prishtina në Obilinq, dhe Drejtoria në fjalë të vjen me një sqarim shtesë në Kuvend.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Alban Ibrahimimi për marrjen në shfrytëzim të parcelës 126/5 për parkingun e automjeteve të peshave të rënda.

Enver Gashi – Unë po befasohem pse zyra pritëse me lejue me ardhë te ne kjo kërkesë sepse kërkesa në fjalë është dashur të shkoj në DPUKP për shqyrtim pastaj, nëse ka nevojë Kuvendi merret me atë kërkesë.

Kryesuesja – Zyrtari i zyrës pritëse gjithsesi ia sqaron, por nëse kërkuesi insiston që kërkesa me shkue në Kuvend, atëherë nuk mundet me ia mohue.

Sami Ahmeti – Realisht këu, po duket se ai ka bërë kërkesë gabim sepse ai është banor i Prishtinës, që është dashur me bë kërkesë në Komunën e Prishtinës meqë, fshati Barilevë është me Prishtinën. Nëse, dojmë me u thellue pak në kërkesë ai nuk ka dhënë asnjë shpjegim, përveç asaj se është posedues i autobusëve dhe kamionëve. Pra, nuk ka dhënë ndonjë shpjegim se cila është e mira për Komunën e Obiliqit, sepse ne kur e japim një parcelë e japim për të mirën e qytetarëve të Obiliqit, pa dashtë me u ndje keq banorët e Komunave tjera, por ata e kanë përfaqësues Komunën e Prishtinës. Edhe unë jam dakord që kërkesa njëherë të trajtohet nga Drejtoria përkatëse pastaj, nëse ka ndonjë rekomandim të vjen në Kuvend.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan DPUKP-së, shqyrtimin e kërkesës së Alban Ibrahimit.

Pika 7 e rendit të ditës

Sami Ahmeti – Në ditët e fundit kam disa kërkesa kryesisht për QKMF-në, për nivelin e mykut dhe ndotjes që është gjithandej saj. Unë nuk i kam të faktuara sepse nuk kam qenë vetë dhe nuk kam fotografi të tyre, por kisha pasë dëshirë që në seancën e radhës të na jepë shpjegim dikush përse është kjo gjendje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:23'

Bashk. prof. për punë të KK


Azize Zeneli

